



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_/\_\_\_/ 2018

**V E N D I M**

**Nr. 23, Datë 11 / 01 / 2018**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr. 01, datë 03.01.2018, të znj.E. H, me objekt pretendimin për diskriminim “*për shkak të gjendjes ekonomike*” dhe “*për shkak të aftësisë së kufizuar*”, nga ana e ish-Komunës “Rrethina”, Shkodër<sup>1</sup>.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I :**

Znj.E. H, në formularin e ankesës informon se: “*Jam paraqitur në Dhjetor të vitit 2015 në Komunën “Rrethina”, duke kërkuar ndihmë për strehim. Nuk ka ardhur askush për të verifikuar gjendjen e shtëpisë time. Ajo është e pabanueshme dhe mund të shembet nga dita në ditë. Im shoq është i paaftë për punë, pasi vuan nga veshkat prej 15 vitesh. Ne marrim ndihmë ekonomike të pamjaftueshme për të rregulluar shtëpinë*”. Në këto kushte, ankuesja kërkon nga Bashkia Shkodër që ta ndihmojë me problemin e strehimit.

Për sa më sipër, me qëllim marrjen e një informacioni më të detajuar dhe të saktë, me datë 04.01.2018, i është dërguar e-mail Specialistes së Zyrës Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Shkodër, ku i është kërkuar informacion më i hollësishëm për të bërë të mundur shqyrtimin e ankesës. Ankuesja nuk kishte dhënë asnjë informacion (apo paraqitur

<sup>1</sup> Sot është pjesë e Bashkisë Shkodër dhe nën administrimin e saj.

<sup>2</sup> Në vijim të vendimit do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

ndonjë dokument) lidhur me pretendimin se në vitin 2015 i është drejtuar me kërkesë ish-Komunës “Rrethina”, e cila aktualisht është në juridiksionin e Bashkisë Shkodër.

Po me këtë datë, Zyra Rajonale e KMD-së Shkodër ka informuar Komisionerin se: *“...Zonja nuk është drejtuar me shkresë as pranë Bashkisë Shkodër dhe as pranë ish-Komunës “Rrethina”. Bisedën e ka bërë verbalisht me nënkryetarin e Komunës, me besimin se ai do ta ndihmonte për ta zgjidhur këtë problem”*.

Gjendja ekonomike dhe aftësia e kufizuar janë shkaqe për të cilat Ligji Nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

*Së pari, bazuar në vetë deklaratimet e ankueses, rezulton se nuk ka asnjë kërkesë/shkresë zyrtare drejtuar Bashkisë Shkodër, (apo ish-Komunës “Rrethina”, Shkodër, sot Njësi Administrative pranë Bashkisë Shkodër) pasi znj.E. H shprehet se vetëm ka biseduar me ish-kryetarin e Komunës “Rrethina”, Shkodër, dhe ai i kishte premtuar se do ta ndihmonte për problemin e strehimit të saj.*

Bazuar në nenin 33, pika 4/b/ç, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, nuk përmbushen kriteret e përcaktuara nga ky Ligj, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Komisioneri thekson se, në bazë të ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njëjësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ish-Komuna “Rrethina” aktualisht është pjesë e Bashkisë Shkodër dhe nën administrimin e saj.

Të gjitha familjet, të cilat aplikojnë për t'u regjistruar si familje të pastreha, kanë detyrim ligjor të plotësojnë dhe të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin administrativo-ligjor sipas kërkesave që parashikon Ligji Nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Në këto kushte, qytetarja E. H, duhet të plotësojë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Ligjin Nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (i ndryshuar), si dhe VKM nr. 574, datë 29.08.2012 “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t'u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore” dhe ta dorëzojë pranë Bashkisë Shkodër.

Në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër<sup>3</sup> është publikuar dokumentacioni që duhet dorëzuar nga ana e qytetarëve për të aplikuar për strehim: (Dokumentacioni më pas kalon për shqyrtim në Këshill Bashkiak).

- Kërkesa për t'u trajtuar me strehim, bazuar në ligjin nr.9232 datë 13.05.2004. (formular i gatshëm që merret në Bashki)
- Deklaratë e vërtetimit të informacionit paraprak, tek noteri.
- Çertifikatën personale dhe familjare.
- Fotokopje karte identiteti
- Vërtetim rajoni për vendbanimin dhe kërkesë strehimi.
- Mandat pagese 200 ( dyqind ) lekë, pagese në Bashki.

*Së dyti, znj. E. H i referohet një kërkesë të bërë verbalisht në vitin 2015 pranë ish-Komunës “Rrethina”, ndërkohë që ankesën e ka paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit më datë 03.01.2018<sup>4</sup>, pra më vonë se një vit nga marrja dijani.*

---

<sup>3</sup> Linku: [http://ëëë.bashkiashkoder.gov.al/ëëb/Strehimi\\_dhe\\_ndertesat\\_270\\_1.php](http://ëëë.bashkiashkoder.gov.al/ëëb/Strehimi_dhe_ndertesat_270_1.php)

<sup>4</sup> Data e regjistrimit të ankesës pranë KMD-së.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, germa dh), të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose një vit nga marrja e dëmtuari, për këtë fakt”*, ankesa e znj.E. Ha, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 33, pika 2, si dhe në nenin 33, pika 4/b/ç, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës së znj.E. H, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. I rekomandohet subjektit ankues të plotësojë dokumentacionin e kërkuar për të përfituar strehim nga programet e strehimit pranë Bashkisë Shkodër.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

**KOMISIONERI**

Fusha: Shërbime

Shkaku: Gjendja ekonomike, Aftësia e kufizuar